Njëjtou... 19.05.2014

Nr 674
dt. 19.05.2014

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

MINISTRI

Nr. 3934 Prot.

Tiranë, më 15.05.2014

# URDHËR

Nr. 195, datë 15.05.2014

PËR

## NJË SHTESË NË URDHRIN NR. 82, DATË 22.02.2011, TË MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SHKENCËS "PËR ORGANIZIMIN E PROVIMIT TË SHTETIT PËR PROFESIONET E RREGULLUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 10 të ligjit nr.10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

***URDHËROJ:***

1. Pas nenit 6, të Rregullores së miratuar me Urdhrin nr. 82, datë 22.02.2011, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për organizimin e provimit të shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të shtohet neni 6/1, me këtë përmbajtje:

   *"6/1. Provimet e shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit organizohen vetëm në 2 sesionet e mëposhtme:*
   *a) javën e parë deri në javën e tretë të muajit korrik;*
   *b) javën e tretë të nëntorit deri në javën e katërt të dhjetorit".*

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**LINDITA NIKOLLA**

**MINISTËR**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT TIRANË

Nr. 23, AL-1001, Tiranë
Tel: +355 4 2222260, Fax : +355 4 2232002
Web site: www.mash.gov.al.